

**Opinion lidhur me kërkesën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit nëse publikimi i emrave të uzurpatoreve të cilët në mënyrë të jashtëligjshme i kanë shfrytëzuar apo aktualisht i shfrytëzojnë pronat e Ndërmarrjeve Shoqërore paraqet shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe nëse publikimi i emrave për personat fizik dhe juridik të cilët kanë privatizuar (blerë) ndërmarrjet shoqërore ose asetet e tyre paraqet shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.**

Sipas nenit 38 (paragrafi 1) të Ligjit nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme LMDHP), Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme Agjencia) ka për detyrë që të këshillojë institucionet publike për të gjitha çështjet e lidhura me mbrojtjen e të dhënave kur kjo kërkohet, duke përfshirë edhe interpretimin dhe zbatimin e ligjeve përkatëse.

**Publikimi i emrave të uzurpatoreve të cilët në mënyrë të jashtëligjshme i kanë shfrytëzuar apo aktualisht i shfrytëzojnë pronat e ndërmarrjeve shoqërore, si dhe publikimi i emrave për personat fizik dhe juridik, të cilët kanë privatizuar (blerë) ndërmarrjet shoqërore ose asetet e tyre nuk është në kundërshtim me LMDHP.**

E dhënë personale, sipas nenit 2 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.1) të LMDHP-së është çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikueshëm (subjekt i të dhënave) i cili mund të identifikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në veçanti në bazë të një ose më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij ose saj fizik, psikologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror.

Përpunim i të dhënave personale është çdo veprim ose një seri veprimesh të cilat kryhen në të dhënat personale, qoftë me ose pa ndihmën e mjeteve automatike, siç janë: grumbullimi, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, korrigjimi, konsultimi, përdorimi, zbulimi përmes transferimit, shpërndarjes ose **mënyrave tjera të vënies në dispozicion**, bashkimi ose kombinimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi.

Ligji Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale. Një nga parimet e përpunimit është që të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme dhe të ligjshme pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave.

Përpunimi i ligjshëm, sipas nenit 5 të LMDHP, konsiderohen rastet kur të dhënat personale përpunohen vetëm nëse plotësohen disa kritere. Një nga kriteret që të dhënat personale mund të përpunohen është kur përpunimi është i domosdoshëm për

respektimin e obligimit ligjor të cilit i nënshtrohet kontrolluesi.

Po ashtu neni 5 (paragrafin 1, nënparagrafi 1.6) përcakton se përpunimi është i domosdoshëm për qëllime të interesave legjitime të ushtruara nga kontrolluesi ose pala e tretë apo palët, të cilave u janë zbuluar të dhënat, me përjashtim të rasteve kur interesat e tilla janë në kundërshtim me të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave.

Të dhënat personale duhet të përpunohen për qëllime të qarta dhe legjitime, e që në këtë rast, qëllim legjitim i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është që përmes publikimit të këtyre listave të ndikojë në luftimin e dukurisë negative të uzurpimit dhe shfrytëzimit të paligjshëm të pronave, që janë ndërmarrje shoqërore, si dhe të të arrihet mbrojtja e shoqërisë nga kjo dukuri negative.

Sipas nenit 36, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale, ndërsa mbledhja, ruajtja, qasja, korigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj. Megjithatë, të gjitha të drejtat dhe liritë e garantuara me kushtetutë mund të kufizohen në pajtim me nenin 55 të saj. Kushtet kryesore, sipas të cilave mund të kufizohet një e drejtë kushtetuese janë që kufizimi duhet të bëhet me ligj, duhet të respektohet parimi i proporcionalitetit konform nenit 55, (paragrafi 2), ku të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.

E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale është e drejtë thelbësore, por jo edhe e drejtë absolute, është e drejtë e cila duhet të balancohet me të drejta të tjera. Çështja e shfrytëzimit dhe uzurpimit të pronave të ndërmarrjeve shoqërore është diskutuar edhe në medime dhe më gjerë. Andaj, ofrimi i informacioneve se kush ka privatizuar, shfrytëzuar apo uzurpuar është në interes të publikut, pasi që kjo do të mundësonte largimin e dyshimit për shfrytëzimin e pronave të këtyre ndërmarrjeve. Interes publik është edhe rritja e transparencës dhe llogaridhënies.

Në nenin 5 (paragrafin 1, nënparagrafin 1.5) të LMDHP-së përcaktohet se përpunimi është i domosdoshëm për kryerjen e një detyre me interes publik ose në ushtrimin e autoritetit zyrtar që i është dhënë kontrolluesit apo një pale të tretë, të cilës i zbulohen të dhënat.

Bazuar në këtë, Agjencia konsideron se publikimi i listave nga Agjencia Kosovare e Privatizimit i shërben interesit thelbësor të publikut, nga se interesi i përgjithshëm i publikut është rritja e transparencës dhe llogaridhënies.

Ndërhyrja që i bëhet individit në lidhje me të drejtën e tij të për mbrojtjen e disa të dhënave është në proporcion me qëllimin që synohet të arrihet përmes publikimit të listave.

Pas arritjes së qëllimit është obligim ligjor i kontrolluesit që këto lista t'i heqë nga publikimi.

**Duke i marrë parasysh argumentet dhe shqyrtimet si më sipër, mund të konkludohet se publikimi i emrave të uzurpatorëve, të cilët në mënyrë të jashtëligjshme i kanë shfrytëzuar apo aktualisht i shfrytëzojnë pronat e ndërmarrjeve shoqërore, si dhe publikimi i emrave për personat fizik dhe juridik, të cilët kanë privatizuar (blerë) ndërmarrjet shoqërore ose asetet e tyre nuk është në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.**